

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Departamenti I
 Pergjithshem - Divizioni Civil, Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te
 paditesit nga Fsh. Komuna e Mitrovices, te cilin sipas
 autorizimit me shkrim e perfaqson Av. nga Mitrovica, kunder te
 paditurit nga Fsh. Komuna e Mitrovices, tani me vendbanim
 te panjohur, te cilin e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem avokati
 nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaj gjykate, per vertetim pronsie,
 vlera e kontestit 240.00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.
 01.12.2016, bie kete:

AKT GJYKIM

I - VERTETOHET se paditesi nga nga Fsh.
 Komuna e Mitrovices eshte pronar i paluejtshmerise - pjeses se ngastres katastrale
 nr. ne siperfaqe prej S= me kulture are e klases se trete, ne vendin e
 quajtur " me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te
 ekspertizes , e cila evidentohet ne emer te te paditurit
 ZK Mitrovica.

II - OBLIGOHET i padituri qe t'ia njoh kete te drejte paditesit, ne afatin
 prej 15 (pesembdhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

OBLIGOHET paditesi qe t'ia kompenzoje shpenzimet perfaqesuesit te
 perkohshem nga Mitrovica, shumen 135,20 euro, ne afat prej
 15 diteve nga dita e pranimit te ketij aktgjykimit, nen kercnim te permbarimit te
 dhunshem.

Secila pale i barte shpenzimet e tjera te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padin e tij te parashtuar dhe permes te autorizuarit te tij ne
 seancat e mbajtura ka theksuar se qysh ne vitin 1980 ne baze te kontrates gopjore, e
 ka blere nga i padituri paluejtshmerine me cmim prej 20.000,00 DM, ne siperfaqe
 rreth afer 400 m2, te cilin qmim ia ka paguar ne teresi shitesit dhe se prej atij momenti
 ka hyre ne shfrytezim dhe posedim te papenguar dhe te panderprer e gjer me tani,
 andaj ka interes juridik qe te vertetohet se ai eshte pronar i pjeses te kesaj
 paluejtshmerie.

I autorizuari i paditsit ne seancen e shqyrtimit kryesor ne fjalen-perfundimtare deklaroi se mbetem ne teresi prane padise dhe kerkespadise se parashtruar me propozim qe duke bere precizimin e kerkesapdise sa I perket siperfaqes, shtrirjes dhe perkufizimit te paluajtshmerise dhe ate sipas konstatimit dhe mendimit te ekspertit gjeodet te cekur si ne ekspertizen e dt. 01.07.2015. Njeherit propozoj qe lidhur me rrethanat nga padija te degjohen ne cilesi te deshmitareve nga Mitrovica dhe nga fsh. Ne fjalen e tij perfundimtare ka theksuar se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazushmerija e kerkespadis, andaj gjykates i propozoj qe te njejten ta aprovoj si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.

Perfaqesuesi i perkoheshem i te paditurit ne seancen e shqyrtimit kryesor theksoi se fillimisht e kundershtoj padin dhe kerkespadin e paditesit, nuk e kundershtoj nxerrjen e provave, kurse ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: certifikaten e pronesise me nr.te lendes Shupkove ZKK Mitrovice ne emer te te paditurit, procesverbalin mbi vendeshiqimin te kesaj gjykate te dt. 17.06.2015, ekspertizen gjeodete ne emer te ekspertit gjeodet beri veshtrim nga Mitrovica dhe skicen e terenit te te njejtit ekspert gjeodet, degjoi deshmitaret dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga Certifikata mbi te drejttat e prones se paluajtshme te cekur me lart, konstatohet se pjesa e parceles katastrale evidentohet ne emer te te paditurit.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin te kesaj gjykate te cekur me larte, konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejt ne vende dhe sipas deklarates se ekspertit konstatoi se paluajtshmerija eshte e kufizuar ne anen lindore me rrugen maxhistrale Mitrovice- Prishtine, ndersa me te gjitha anet tjera me prone private. Paluejtshmeria eshte e rrethuar me rrethoje prej teli, ne te eshte te ndertuar nje shtepize pune.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera ne pjeset e parcelave kontestuese nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, ka vertetuar se pjesa e aluajshmerise kontestuese bien - gjegjesisht e perbejne pjeset e parcelve te cekura me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe plotsimit te saj dhe skicen e terenit, e cila eshte pjese perberese e kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga skica e terenit te dt. 14.04.2016, shifet shtrirja, vendi, perkufizimi dhe siperfaqja e paluajshmerise tani lendore.

Deshmitari deklaroi se ai personalisht e din se tani paditsi e ka blere ne vitin 1980 kete patundeshmeri nga shitesi , ne siperfaqe rreth 4 ari, me cmim te shiteblerejes prej 20,000 DM. te cilin cmim bleresi ia ka paguar ne teresi shitesit. E di se shitblerja eshte bere sipas marreveshjes gojore dhe nuk e di se kane bere ndonje kontrat me shkrim nga se aty kam qene presonalisht present kur e kane kryer shitblerjen. E di se kur e ka blere aty nuk ka pas ndonje objekt te ndertuar ne patundeshmeri por e njejta ka qene vetem kullose. Ajo paluajshmeri nuk ka qene e rrethekuar por vetem e ndame me gure te megjes. Ndersa pas nje kohe te njejten e kane ndare me gardh prej telit. Por e di se menjehere ka hyr ne shfrytezim dhe posedim se bashku me aneteret e familjes dhe te cilen e kane shfrytezuar pa nderprere ne menyre te papengueshme nga askush. Keto rrethana me jane te njohura sepse une kam raporte miqesore me ta dhe kam shkuar si mysafir te te njejtit.

Deshmitari deklaroi se ai peronalisht e din se tani paditsi e ka blere ne vitin 1980 kete patundeshmeri nga shitesi emiri i te cilit tani per tani nuk me kujtohet , ne siperfaqe rreth 4 ari, me cmim te shiteblerejes prej 20,000 DM. te cilin cmim bleresi ia ka paguar ne teresi shitesit. E di shitblerja eshte bere sipas marreveshjes gojore dhe nuk e di se kane bere ndonje kontrat me shkrim nga se aty kam qene presonalisht present kur e kane kryer shitblerjen. E di se kur e kane blere aty nuk ka pas ndonje shpi te ndertuar ne patundeshmeri por e njejta ka qene vetem kullose. Nga njeher e kane punuar. Ajo paluajshmeri nuk ka qene e rrethekuar por vetem e ndame me gure te megjes. Por e di se menjehere ka hyr ne shfrytezim dhe posedim se bashku me aneteret e familjes dhe te cilen e kane shfrytezuar pa nderprere ne menyre te papengueshme nga askush dhe nuk e di se dikush ndonjeher I ka penguar ne posedimin e asaj toke. Keto rrethana me jane te njohura sepse une kam raporte miqesore me ta dhe kam shkuar si mysafir te te njejtit.

Nga nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte, gjykata konstatoi se paditesi e ka fituar te drejten e pronesise ne pjesen e parceles se lartcekuraar e cila eshte objekt shqyrtimi te cilen e kishte pasur ne posedim dhe shfrytezim shum vite me pare, duke e shfrytezuar kete padundeshmeri me gjate se 20 vite, kohe kjo e parapare per fitimin e te drejtes se prones ne baze te parashkrimit fitues - me mbajtje konform dispozites se nenit 28.4 te Ligjit mbi Marredhieniet Themelore Juridike - Pronesore, ku eshte percaktuar se mbajttesi me mirebesim i sendit te palucjtshem , mbi te cilin tjetri ka te drejten e pronesise, fiton te drejten e pronesise mbi kete send me parashkrimin fitues me kalimin e kohes prej 20 (njezet) vjetesh.

Paditsi te drejten e pronesise ne kete patundeshmeri e ka fituar edhe konform nenit 73 te Ligjit per Marredheniet Detyrimore pasi qe kontraten gojore te lidhur ne mes tij dhe shitsit - paditurit e kishte permbushur ne teresi, pasiqe e kishte paguar emimin kontraktues dhe poashtu kishte hyr ne posedim dhe shfrytezim te kesaj patundeshmerie menjeher pas blerjes se te njejtes duke mos qene i penguar nga askush e te cilen edhe sot e shfrytezone. Poashtu ne kontekstin e provave te larte cekura, gjykata ne baze te proves se vendshiqimit, konstatoj se paditsi edhe tani e tutje e ka ne posedim dhe shfrytzim kete paluejtshmeri, ne vijimsi te konsiderates se te njejten e ka ne posedim te vetin te fituar me shitblerje dhe me mbajtje me mirebesim.

Kete gjendje te tille faktike gjykata e vertetoi ne baze te deshmive te deshmitareve nga Mitrovica dhe nga fsh. te cileve ua fali besimin e plote, pasiqe te njejtat ishin bindese dhe ne harmoni me kerkespadine.

Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP dhe LMD, nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim kane qene ligjet e lartecekura.


Vendimi mbi shpenzimet e perfaqesuesit te perkohshem u bazua ne dispoziten e nenit 453. 2 te LPK-se duke i njohur shpenzimet per pjesemarrje te perfaqesuesit te perkohshem dhe ate per nje seance te mbajtur, shumen prej 135 euro, e konform nenit 7 te TA.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e tjera te procedures kontestimore, bazohet konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga arsyet e paraqitura me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.100/2016, dt.01.12.2016.

Gjyqtari,
Skender Shala



KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afat prej 15 (pese mbledhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.